



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 62, datë 22.08.2016

Për

**“MIRATIMI I PAGESËS PËR PAK E INVALIDËT E PUNËS
PËR PERIUdhËN 1-31 GUSHT 2016”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen Vendore”; neneve 7, 8, 11, 20, 23 dhe nenit 29, pika 2 të Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 për “Ndhmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar); Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e Invalidëve të Punës”(i ndryshuar); Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbërit” (i ndryshuar); Ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 për “Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Ministrave nr.277, datë 18.06.1997 për “Përfitimet nga statusi i të verbërit”(i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Ministrave nr.31, datë 20.01.2001 për “Përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Ministrave. nr.618, datë 07.09.2006 për “Përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Ministrave nr.869, datë 18.06.2008 për “Zbatimin e Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 07.02.2007 për “Masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjeno - sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.24, datë 20.08.2015 mbi “Zbatimin e Vendimit nr.277, datë 18.6.1997; Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.3, datë 10.03.2014 për “Planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.22, datë 20.08.2015, mbi “Zbatimin e Vendimit nr.618, datë 07.09.2006, të Këshillit Ministrave, për “Përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.9, datë 25.02.2015, mbi “Zbatimin e Vendimit nr.404 datë 20.06.2012 të Këshillit Ministrave, për “Përcaktimin e masës së kriterëve dhe procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”; Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.23, datë 20.08.2015 mbi “Zbatimin e vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit Ministrave për “Përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); të Këshillit të

Ministrave, për “Përfitimet nga statusi i të verbrit” (i ndryshuar) me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tiranë:

V E N D O S I:

1. Të miratohet pagesa për personat me aftësi të kufizuar, për muajin Gusht 2016 për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI